

STATUTI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
"WR" SHPK
EMERTIMI-OBJEKTI-QENDRA-KOHEZGJATJA

NENI 1 - Emërtimi i shoqërisë

Shtetasja shqiptare:

MATILDA LETA, shtetase shqiptare, lindur më 19/08/1992, në Tirane dhe banuese në adresën: Rruga Ramazan Disha Nd.22 H1 Njësia Admin 4 kodit postar 1007 Tirane , mbajtëse i kartës së identitetit me nr. Personal J25819043I është ortak i vetëm i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar e quajtur "WR" shpk.

Shoqëria është person juridik dhe do ushtrojë veprimtarinë në bazë të ligjit Nr. 9901 datë 14.04.2008 «Për tregtarët dhe Shoqëritë tregtare» i ndryshuar.

NENI 2- Objekti i veprimtarisë së shoqërisë

Objekti i veprimtarisë së shoqërisë do jete si vijon:

- Shërbime informatike. Përpunim të dhënash për pale të treta. Shërbim klienti virtual. Dizajnimi dhe mirëmbajtje web. Shërbime burimesh njerëzore. Mirëmbajtje rrjetesh sociale. Shërbime marketingu.
- Shërbime konsulencë, suport, implementimi, trajnimi dhe edukimi në fushën e IT.
- Shërbimeve të internetit si webhosting, domain, email, data transmitting WAN, LAN, FO,VOIP, IPTV. Konceptim, dizajnimi, brandim, prodhim dhe shitje të produkteve të fushës së promovimit dhe grafikes

NENI 3 - Kohëzgjatja e veprimtarisë

Shoqëria do të ushtrojë aktivitetin tregtar do jetë subjekt i të drejtës shqiptare pa afat të përcaktuar.

Me vendim të ortakut të vetëm afati i mësipërm mund të ndryshojë ose shoqëria mund të shkrihet.

NENI 4 - Vula

Shoqëria do të ketë vulën e vet në formën e përcaktuar nga ortakut

NENI 5 - Selia e shoqërisë

Shoqëria "WR" Shpk ka qendrën në Adresën Rr e Dibrës Kompleksi Orion 1 pranë Komisarariatit Nr. 4 Tirane 1005 Njësia Bashkiake nr. 4 dhe do të ketë të drejtë të ushtrojë aktivitetin e saj në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Shoqëria mund të krijojë agjenci, zyra përfaqësimi, qendra dytësore në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

NENI 6 - Kapitali i regjistruar

Kapitali i shoqërisë është LEKE 100.000 (njëqind mijë lekë) dhe është kapital i ortakut të vetëm.

Kapitali është i ndare në 1 kuote me vlere 100.000 lekë (njëqind mijë lekë).

Kapitali i shoqërisë mund të rritet apo zvogëlohet me vendim të ortakut të vetëm.

NENI 7-Transferimi i kuotave

Kuotat e kapitalit janë lirisht të transferueshme.

1. Kuotat e kapitalit të shoqërisë si dhe të drejtat që rrjedhin prej tyre me vendim të ortakut të vetëm mund të fitohen apo kalohen nëpërmjet:

- a) kontributit në kapitalin e shoqërisë;
- b) shitblerjes;
- c) trashëgimisë;
- d) dhurimit; (si personave që kanë lidhje gjaku me ortakun e vetëm ashtu edhe të tjerëve pa lidhje gjaku)
- e) çdo mënyre tjetër të parashikuar me ligj.

2. Në rastin e kalimit të kuotave me kontratë, kontrata duhet të bëhet me shkrim.

NENI 8 Ortaku i vetëm

Shoqëria zotërohet nga një ortak dhe të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së përgjithshme ushtrohen nga ortakut i vetëm. Të gjitha vendimet e marra nga ortakut i vetëm regjistrohen në një regjistër të vendimeve, të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen.

Duhet regjistruar në veçanti, por pa u kufizuar në to, vendimet për:

- Miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecures se veprimtarisë;
- Shpërndarjen e fitimeve vjetore dhe mbulimin e humbjeve;
- Investimet e reja;
- Vendimet për riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë.

Vendimet e paregjistruara në regjistrin e vendimeve janë absolutisht të pavlefshme.

Shoqëria nuk mund t'i kundrejtojë pavlefshmërinë të tretit, që ka fituar të drejta në mirëbesim, përveç rastit kur shoqëria vendos ndryshe.

NENI 9-Drejtimi dhe administrimi

9.1 Shoqëria tregtare "WR" shpk do drejtohet nga një administrator që emërohet me vendim të ortakut të vetëm.

Administrator i Shoqërisë duke filluar nga data e sotme për pesë vitet në vazhdim (05/04/2023 deri 04/04/2028) do të jetë ortakut i vetëm
Matilda Leta



Administratori ka të drejtë e detyrohet të:

- kryejë të gjitha veprimet e administrimit të veprimtarisë tregtare të shoqërisë, duke zbatuar politikatat tregtare, të vendosura nga ortakut i vetëm;
- përfaqëson shoqërinë tregtare;
- kujdeset për mbajtjen e saktë e të rregullt të dokumenteve dhe të librave kontabël të shoqërisë;
- përgatit dhe nënshkruan bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurisë së veprimtarisë dhe, së bashku me propozimet për shpërndarjen e fitimeve, i paraqesin këto dokumente përpara ortakut të vetëm për miratim;
- krijon një sistem paralajmërimi në kohën e duhur për rrethanat, që kërcënojnë mbarëvajtjen e veprimtarisë dhe ekzistencën e shoqërisë;
- kryen regjistrimet dhe dërgojnë të dhënat e detyrueshme të shoqërisë, siç parashikohet në ligjin për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;
- raporton përpara ortakut të vetëm në lidhje me zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimeve të posaçme me rëndësi të veçantë për veprimtarinë e shoqërisë tregtare;

9.3 Ortaku i vetëm mund ta shkarkojë administratorin në çdo kohë. Statuti apo marrëveshje të tjera nuk mund ta përjashtojnë apo kufizojnë këtë të drejtë.

Paditë, që lidhen me shpërblimin e administratorit, në bazë të marrëdhënieve kontraktore me shoqërinë, rregullohen sipas dispozitave ligjore në fuqi.

9.4. Administratori do shpërblehet sipas përcaktimit të ortakut të vetëm në përputhje me parashikimin e nenit 97 të ligjit nr.9901 date 14.04.2008.

9.5 Administratori ka të drejtë të caktojë dhe revokojë persona të tretë në mungesë dhe për llogari të tij.

NENI 10 -Kontrolli i brendshëm

Shoqëria tregtare organizon kontrollin e brendshëm me një kontabël të miratuar, i cili është përgjegjës përpara kësaj shoqërie për dëmet që mund të shkaktojë nga moskryerja në rregull e detyrës së tij.

NENI 11—Bilanci dhe të ardhurat

Veprimet ekonomike e financiare të shoqërisë mbyllen më 31 dhjetor të çdo viti përveç rasteve e urdhrave të veçanta të ortakut të vetëm të saj. Në fund të çdo periudhe ushtrimore nxirret bilanci kontabël me rezultatin ekonomik HUMBJE FITIME.

Bilanci kontabël miratohet brenda datës 31 mars të vitit pasardhës dhe pas përcaktimit të detyrimeve fiskale pjesa që mbetet i jepet për përdorim Ortakut të vetëm të saj.

NENI 12—Shpërbërja e shoqërisë

Shpërbërja e shoqërisë mund të vijë në çdo kohë dhe për çfarëdo shkak. Në rast shkrirje të shoqërisë, Ortaku i vetëm vendos mbi mënyrat e likuidimit dhe cakton një ose më shume likuidatorë duke iu përcaktuar edhe detyrat.

Në rastin e likuidimit emërtimi i shoqërisë do të shoqërohet nga shënimi:

SHOQERI NE LIKUIDIM E SIPER.

Administratori regjistron prishjen e shoqërisë pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, në përputhje me nenin 43 të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007 "Për Qendrën Kombëtare të Regjistrimit".

NENI 13-Dispozita përfundimtare

Për sa nuk është shprehur plotësisht në këtë statut do i referohet plotësimeve të bëra nga ORTAKU I VETEM.

Shoqëria "WR" shpk. do të jetë subjekt i të drejtës shqiptare dhe do ushtrojë aktivitetin e saj në përputhje me normat e legjislacionit shqiptar në përgjithësi dhe normat e këtij statuti. Ky statut nënshkruhet prej ortakut në datë 05/04/2023.

ORTAKU I VETEM

Matilda Zeta